



PËRSHËNDETJE E PARTISË KOMUNISTE TË BRAZILIT PARAQITUR NGA SHOKU BERNARDO JOFILI

Të dashur shoqe dhe shokë,

Partia komuniste e Brazilit falenderon PKSH për ftesën për të marrë pjesë në këtë homazh me rastin e 100 vjetorit të shokut Enver Hoxha. Jemi këtu, komunistë nga të gjitha vendet e kontinentet, që luftojnë në kushte të ndryshme për qëllimin e përbashkët të luftës revolucionare kundër kapitalizmit, për ndërtimin e një shoqërie të lirë nga shtypja e njeriun prej njeriut. Na bashkon në Tiranë kujtimi dhe trashëgimia e një gjigandi të lëvizjes sonë në shekullin e kaluar, të Enver Hoxhës.

Shoku Enver, lindur në Gjirokastrë, 100 vjet të shkuara, ishte themeluesi i PKSH që më vonë mori emrin PPSH, e cila drejtoi luftën antifashiste të çlirimit kombëtar kundër hordhive nazifashiste deri në çlirimin e vendit më 1944, që për katër dekada drejtoi ndërtimin e socializmit në Shqipëri në mënyrë origjinale. Njeri i parimeve, mendimtar marksist-leninist, luftëtar i palodhur kundër imperializmit. Duke u shquar si një internacionalist konsekuent Enver Hoxha është një mik i paharruar i popullit brazilian e i PK të Brazilit. Veçanërisht ishte një mik personal shumë i dashur i udhëheqësit tonë historik, shokut Amazon (1912 – 2002).

PK e Brazilit kurrë s'do ta harrojë ndihmën që Shqipëria dhe Enver Hoxha na dha në një moment shumë të vështirë për vendin tonë në vitet 1960 – 1970, kur vendi ynë vuante nën thundrën e diktaturës ushtarake fashiste dhe kur partia jonë u ngrit në luftën e armatosur në Araguaia. Censura e shtypit bënte që kjo luftë të mos përkrahej në Brazil, por në atë kohë ishte Radio Tirana ajo që ngriti në këmbë mijëra banorë në përkrahje të kësaj epopeje partizane. Për ne kujtimi i Shqipërisë socialiste dhe udhëheqësit të saj Enver Hoxha është i lidhur me luftën për liri e demokraci që e ndihmuan aq shumë vendin tonë.

Enver Hoxha vdiq më 11 prill 1985, para një çerek shekulli. Pas vdekjes së tij vjen ofenziva kundërrevolucionare e viteve 1989 – 1990 e cila likudoi eksperiencën sovjetike të viteve 1917. E njejta ofenzivë likuidoi gjithashtu eksperiencën shqiptare dhe PPSH, e cila u shkri me preteksin për t'iu përshtatur kushteve të reja. U krijua një ambient ndërkombëtar kundër forcave të progresit dhe revolucionit. Sot është e qartë se triumfi i reaksionit borgjez është i përkohshëm. Regjimi i vjetër kapitalist është i mbërthyer nga një krizë e rëndë me qendër në SHBA, ku dalin në pah kontradikta të pashpresa. Recetat e borgjezisë dhe qeverive të tyre përballë krizës tregojnë që kapitalizmi është një sistem në kalbëzim. Ndërsa socializmi jeton dhe lulëzon. Jeton në Kinën e madhe, në Vietnam, Korenë e Veriut e në Kubë. Këto vende me trajektoren e tyre inovatore, provojnë vitalitetin e sistemit socialist. Çdo njëri prej tyre ka eksperiencën e vet dhe rrugën e vet. PK e Brazilit konstaton që nuk ka një model unik të socializmit

Enver Hoxha

"për një Shqipëri më të mirë"

"për bashkimin e vërtetë të kombit"

"për mbarëvajtjen e atdheut"



për t'u ndjekur nga të gjithë. Është e natyrshme se këto trajektore konvergojnë e bashkohen me njëra-tjetrën dhe me eksperiencën e socializmit në të kaluarën. PK Brazilit është krenare që ka mësuar nga Shqipëria e Enver Hoxhës.

Ndërsa në Evropë kanë ardhur kohë të vështira, në Amerikën Latine ka 10 vjet që është hapur një cikël i qeverive demokrate, revolucionare e antiimperialiste. Qeveritë progresiste, të llojeve të ndryshme, mbizotërojnë sot në kontinent si në Venezuelën e Hugo Çavezit që shtron nevojën e "socializmit të shekullit 21". Në Brazil ku është zgjedhur e rizgjedhur si president ish udhëheqësi i punëtorëve Luis Ignacio Lula da Silva, PK e Brazilit e ka rrugën të hapur. Në zgjedhjet rajonale të 5 tetorit partia jonë mori 608 këshilltarë dhe 40 prefektë komunistë, në Olinda, Arakahu etj. Nuk do të jetë qeveri rajonale socialiste, por këtu PK e Brazilit konfirmohet si një forcë që ka synim të akumulojë energji për transformime revolucionare të shoqërisë braziliene në të ardhmen, drejt socializmit në vend.

Drejt këtyre sukseseve dhe kësaj perspektive që na mbush me shpresë, nuk kemi dyshim se do të kemi solidaritetin ndërkombëtar të Shqipërisë së Enver Hoxhës. Në 100 vjetorin e këtij njeriu të madh ngrejmë lart flamurin e kuq për ta përshëndetur, që trashëgimia e tij të jetojë e të ngrihet lart sa malet shqiptare, që fara e mbjellë nga ai të përhapet e lulëzojë në gjirin e klasës punëtore shqiptare, e mbajtur gjallë nga PK e Shqipërisë, drejt një hopi tjetër revolucionar dhe një eksperience tjetër socialiste, më e bukur e më frytdhënëse.

Faleminderit!